



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1028 /4 prot

Datë 08.06.2023

V E N D I M
Nr. 484/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-66518-04-19-2023, me objekt “*Shtypshkrime*”, me fond limit 1,433,300 (një milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durrës
Lagjja nr.1, Rruga Tregtare, Durrës

Ankimues: “Inpress” SHPK
Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra
Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.04.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-66518-04-19-2023, me objekt “Shtypshkrime”, me fond limit 1,433,300 (një milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë, pa tvsh lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 26.04.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3055 dhe me nr. 898/2023 protokollin, e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr.1224 prot., datë 03.05.2023 me objekt “kthim përgjigje ankesës nr. 893/2023prot datë 26.04.2023”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, me nr. 898/2 prot., datë 03.05.2023. Konkretisht, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranin plotësisht të ankesës si më poshtë vijon: “[...]Referuar përmbajtjes së ankesës rezulton se, ankuesi ka ngritur pretendimet e mëposhtme:

I. Ankuesi ngre pretendime ndaj kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.1 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar të tenderit në të cilin është parashikuar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2021, 2022), ku vlera e xhiros vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

ARSYETIMI

1.Lidhur me pretendimin e I-rë të ankuesit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA), konstaton se:

Ky kriter duhet ndryshuar, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik. Vërtetimi për xhiron vjetore duhet ndryshuar nga viti (2019, 2020, 2021), duhet bërë (2020, 2021, 2022)

II. Në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuar, Dega Grafike, si dhe minimalisht një teknik printimi të certifikuar të paktën 3 muajt e fundit nga data nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)

2- Për teknikun e printimit të paraqitet certifikata dhe CV

ARSYETIMI

1.Lidhur me pretendimin e II-të të ankuesit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA), konstaton se:

KSHA vendos të ndryshohet kriteri nga “2(dy) punonjës me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e Aplikuar, Dega Grafike.”, të bëhet “ 2(dy) punonjës me arsim të lartë në profilin Grafikë/ Design ose degë ekuivalente me to”.

KSHA vendos të ndryshohet kriteri nga “një teknik printimi të certifikuar të paktën 3 muajt e fundit nga data nga data e zhvillimit të tenderit”, të bëhet “të ketë në staf punonjës printues.”

KSHA vendos të ndryshohet kriteri “Për teknikun e printimit të paraqitet certifikata dhe CV.”, të bëhet “Për teknikun e printimit të paraqitet CV.”

III. Në pikën 2.3.4. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues brenda datës dhe orës së hapjes së kësaj procedure duhet të paraqesë për Zyrës së Protokollit nga një mostër për zërat si më poshtë: 1) Axfordë 2)

Bllok 3) Kartëvizita 4) Kartolina + Zarfa 5) Bazament per flamur tavoline 6) Stilolaps”

ARSYETIMI

1.Lidhur me pretendimin e III-të të ankuesit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA), konstaton se: KSHA vendos të heqë nga lista e mostrave pikën Nr. 4 “Kartolina + Zarfa.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni, pasi administroi dosjen e prokurimit të sipër përmendur, shqyrtoi dhe analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti ankimues. Në përfundim të këtij procesi, komisioni i caktuar

arriti në konkluzionet, që:

Kërkesa e OE ankimues rezultoi e argumentuar dhe për rrjedhojë KSHA-ja konkludon se pretendimet e shoqërisë “INPRESS” SHPK qëndrojnë.

Përgjigja:

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi të pranojë ankesën e paraqitur nga shoqëria “INPRESS” SHPK”.

II.5. Me datë 03.05.2023 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 330/2023 ka vendosur:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-66518-04-19-2023, me objekt “Shtypshkrime”, me fond limit 1,433,300 (një milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë, pa tvsh lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezultoi, se me datë 08.05.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën me modifikimin e dokumenteve të tenderit bazuar në vendimin e KSHA së autoritetit kontraktor, i cili kishte vendosur pranimin e plotë të ankesës. Konkretisht përmbajtja e shtojcës është si më poshtë:

- **Ne Dokumentet Standarde të Tenderit në pikën 2.2.1 të kapacitetit Ekonomik dhe Financiar**

ISHTE

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiron vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit.

BEHET

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit.

➤ **Ne Dokumentet Standarde të Tenderit në pikën 2.3.3 të kapacitetit Teknik**

ISHTE

Në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumenteve Standarde të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuara, Dega Grafike, si dhe minimalisht një teknik printimi të certifikuar të paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

- 1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)
- 2- Për teknikun e printimit të paraqitet certifikata dhe CV.

BEHET

Në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumenteve Standarde të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Grafikë/ Design ose degë ekuivalente me to, si dhe minimalisht të ketë në staf punonjës printues. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

- 1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)
- 2- Për teknikun e printimit të paraqitet CV.

➤ **Ne Dokumentet Standarde të Tenderit në pikën 2.3.4 të kapacitetit Teknik të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”**

ISHTE

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues brenda datës dhe orës së hapjes së kësaj procedure duhet të paraqesë pranë Zyrës së Protokollit nga një mostër për zërat si më poshtë:

- 1) *Axhendë*
- 2) *Bllok*
- 3) *Kartëvizita*
- 4) *Kartolina + Zarfa*
- 5) *Bazament per flamur tavoline*
- 6) *Stilolaps*”

BEHET

2.3.4. *Operatori ekonomik ofertues brenda datës dhe orës së hapjes së kësaj procedure duhet të paraqesë pranë Zyrës së Protokollit nga një mostër për zërat si më poshtë:*

- 1) *Axhendë*
- 2) *Bllok*
- 3) *Kartëvizita*
- 4) *Bazament per flamur tavoline*
- 5) *Stilolaps*”

II.7. Me datë 11.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëherazi pranë autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3091 dhe nr. 1028/2023 prot., datë 11.05.2023 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK duke kundërshtuar modifikimet e kryera nga autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar në SPE me datë 08.05.2023 për kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumenteve Standarde të Tenderit me pretendimin, se pavarësisht që KSHA e autoritetit kontraktor e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, ndryshimet e pasqyruara të DST nuk reflektojnë të gjitha pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK.

II.8. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 1459 prot., datë 17.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 1028/3 prot., datë 19.05.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Inpress SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik se ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “Inpress” SHPK me pretendimin, se “*Kërkesa e OE nuk rezulton e mirëargumentuar dhe për rrjedhojë KSHA-ja konkludon se pretendimet e shoqërisë “Inpress” SHPK nuk qëndrojnë.*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, me arsyen se: *“Në rastin konkret, mund të jetë e pranueshme dhe e logjikshme që ak të kërkojë nga OE pjesëmarrës disponimin e 1 (një) dizjaner, i cili të figurojë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin dhe prodhimin e mallrave të kërkuara, kërkesë kjo që mund të konsiderohet deri diku e pranueshme dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së, si dhe mund të nevojitet, por kurrësesi nuk është e nevojshme disponimi i një stafi të tillë të specializuar sipas përcaktimeve të kërkuara në pikën 2.3.3 të shtojcës 7, të DST. Argumentimi i bërë nga AK se: Ky kriter është i nevojshëm që operatorët pjesëmarrës të provojnë besueshmërinë dhe provojnë e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK,.... ..nuk qendron aspak, pasi si përvoja ashtu edhe besueshmëria e një operatori ekonomik pjesëmarrës vërtetohet kryesisht nëpërmjet punëve të ngjashme dhe xhirove vjetore të kërkuara, ndërsa kërkesa për një staf të tillë të specializuar duhet të lidhet kryesisht dhe drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës, dhe për më shumë do të duhet të jetë në proporcion me kontratën e prokuruar. Rrjedhimisht, ky kriter i vecantë kualifikues do të duhet të ndryshohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi është në kundërshtim të plotë me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik*

“[...]Së dyti, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3. “kapacitet teknike”, të shtojcës 7 “kriteret e vecanta të kualifikimit të dokumentave standarte të tenderit, me anë të së cilës kërkohet që oe pjesëmarrës të kenë në dispozicion punonjës: i. minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin grafikë/ design ose degë ekuivalente me to,të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës: është gjithashtu tërësisht, diskriminues, jo proporcional; dhe mbi të gjitha në kundërshtim të plotë me LPP. nuk ekziston asnjë arsye se përse OE pjesëmarrës do të duhet të disponojnë një staf të tillë të specializuar gjatë gjithë kohës dhe të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Fare mirë një OE pjesëmarrës mund të disponojnë punonjës të specializuar nëpërmjet kontratave të përkohshme apo me kohë të pjeshme dhe në mënyrë të posacme për këtë procedurë prokuruese. Pra nuk ka / ekziston asnjë arsye logjike, ekonomike, teknike, profesionale dhe funksionale përse një OE pjesëmarrës do të duhet të punësojë dhe të ketë në dispozicion gjatë gjithë kohës një staf të tillë të specializuar - i cili të figurojë detyrimisht i regjistruar në listëpagesa, ku fare mirë për projekte dhe detyra të veçanta, mund të punësojë me kohë të pjeshme apo me kontratë të përkohshme staf të specializuar, i cili të kryejë detyrat dhe funksionet e kërkuara për një projekt të caktuar. Rrjedhimisht, AK mund të kërkojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të mund të disponojnë një staf të specializuar për realizimin e një kontrate të caktuar, por ky staf i specializuar jo detyrimisht do të duhet të jetë i punësuar më parë pranë operatorit ekonomik pjesëmarrës. Operatorët ekonomikë të

cilët dëshirojnë të marrin pjesë në një procedurë prokuruese, në përputhje me frymën dhe dispozitat e LLP-së dhe rregullat e prokurimit publik do të duhet të kenë të drejtën që të mund të disponojnë punonjës të specializuar edhe nëpërmjet kontratave të përkohshme apo të pjeshme, posaçërisht për një procedurë prokuruese të caktuar. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimeve të tij (dhjetra vendime të tilla të ngjashme) ka pasur mundësinë dhe është shprehur shumë herë dhe qartazi përsa i përket kësaj pike dhe këtij kriteri, duke përcaktuar qartësisht se operatorët ekonomikë pjesëmarrës mund të disponojnë staf / personel të specializuar me anë të kontratave të përkohshme apo të pjeshme (për të ardhmen), dhe jo domosdoshmërisht do të duhet që këtë staf / personel të specializuar ose pjesëmarrës ti kenë në dispozicion paraprakisht, (në të shkuarën). Për sa mësipër, kriteri kualifikues që OE pjesëmarrës do të duhet të kenë në dispozicion i. minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin grafikë/ design ose degë ekuivalente me to, të cilët duhet të figurojnë në lispagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës: do të duhet të hiqet / ndryshohet, pasi bie në kundërshtim të plotë me LPP.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, të modifikuara “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.3 është parashikuar kriteri si më poshtë:

ISHTE

Në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuara, Dega Grafike, si dhe minimalisht një teknik printimi të certifikuar të paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

- 1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)*
- 2- Për teknikun e printimit të paraqitet certifikata dhe CV.*

BEHET

Në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Grafikë/ Design ose degë ekuivalente me to, si dhe minimalisht të ketë në staf punonjës printues. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)

2- Për teknikun e printimit të paraqitet CV.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
 - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”
- Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.1.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 i LPP-së parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
 - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
 - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një

organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.5 Ndërsa në nenin 39 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Parë në këtë këndvështrim KKP gjykon, se vendosja e e kriteri që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të profilit grafik/designer është në përputhje me natyrën, përmasat dhe volumin e kontratës por autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për uljen e numrit të punonjësve të kërkuar për këtë profil pasi volumi dhe përmasat e kontratës si dhe sasi të artikujve që do të prokurohen nuk e justifikojnë një numër të tillë. Akoma më tej, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor që punonjësit e profilit grafik/design ose degë ekuivalente me to të figurojnë në listpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët e-Sig 025) është kërkesë e ekzagjeruar, pasi e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të specializuar për realizimin e kontratës objekt-prokurimi në kohë dhe me cilësi të cilët të jenë punonjës efektivë për sa kohë do të zgjasë realizimi i kontratës dhe duke e parë në këtë aspekt nuk është e domosdoshme që punonjësit e profilit grafik/design të jenë të punësuar me kohë të plotë që të figurojnë në listpagesat e shoqërisë pasi operatori ekonomik mund të lidhë edhe kontrata të përkohshme me grafik/dizajner apo kompani grafike/dizenjimi për kohën e vlefshmërisë së kontratës me qëllim që profilet e kërkuara të ketë në dispozicion gjatë kësaj kohe për realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të rishikuar kriterin duke ulur numrin e punonjësve të profilit grafik/design ose ekuivalente me to si dhe të rishikojë kriterin *që lista e personelit për profilet më sipër “të shoqërohet me listpagesat e sigurimeve e shoqërore”* pasi operatorët ekonomikë mund të disponojnë punonjësit më sipër edhe përmes kontratave të përkoheshme të vlefshme gjatë kohës së realizimit të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues: “Së dyti, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3. “kapacitet teknike”, të shtojcës 7 “kriteret e vecanta të kualifikimit të

dokumentave standarte të tenderit, me anë të së cilës kërkohet që oe pjesëmarrës të kenë në dispozicion punonjës:ii. si dhe minimalisht 1 (një) punonjës printues... të cilët duhet të figurojnë në lispagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës: është gjithashtu tërësisht, diskriminues, jo proporcional; dhe mbi të gjitha në kundërshtim të plotë me lpp. nuk ekziston asnjë arsye se përse oe pjesëmarrës do të duhet të disponojnë një staf të tillë të specializuar gjatë gjithë kohës dhe të cilët duhet të figurojnë në lispagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. fare mirë një oe pjesëmarrës mund të disponojnë punonjës të specializuar nëpërmjet kontratave të përkohshme apo me kohë të pjeshme dhe në mënyrë të posaçme për këtë procedurë prokuruese. Pra nuk ka / ekziston asnjë arsye logjike, ekonomike, teknike, profesionale dhe funksionale përse një oe pjesëmarrës do të duhet të punësojë dhe të ketë në dispozicion gjatë gjithë kohës një staf të tillë të specializuar - i cili të figurojë detyrimisht i regjistruar në listëpagesa, ku fare mirë për projekte dhe detyra të veçanta, mund të punësojë me kohë të pjeshme apo me kontratë të përkohshme staf të specializuar, i cili të kryejë detyrat dhe funksionet e kërkuara për një projekt të caktuar. Rrjedhimisht, AK mund të kërkojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të mund të disponojnë një staf të specializuar për realizimin e një kontrate të caktuar, por ky staf i specializuar jo detyrimisht do të duhet të jetë i punësuar mëparë pranë operatorit ekonomik pjesëmarrës. Operatorët ekonomikë të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në një procedurë prokuruese, në përputhje me frymën dhe dispozitat e LPP-së dhe rregullat e prokurimit publik do të duhet të kenë të drejtën që të mund të disponojnë punonjës të specializuar edhe nëpërmjet kontratave të përkohshme apo të pjeshme, posaçërisht për një procedurë prokuruese të caktuar. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimeve të tij (dhjetra vendime të tilla të ngjashme) ka pasur mundësinë dhe është shprehur shumë herë dhe qartazi përse i përket kësaj pike dhe këtij kriteri, duke përcaktuar qartësisht se operatorët ekonomikë pjesëmarrës mund të disponojnë staf / personel të specializuar me anë të kontratave të përkohshme apo të pjeshme (për të ardhmen), dhe jo domosdoshmërisht do të duhet që këtë staf / personel të specializuar oe pjesëmarrës ti kenë në dispozicion paraprakisht, (në të shkuarën). për sa mësipër, kriteri kualifikues që OE pjesëmarrës do të duhet të kenë në dispozicionii. si dhe minimalisht 1 (një) punonjës printues... të cilët duhet të figurojnë në lispagesat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës: do të duhet të hiqet / ndryshohet, pasi bie në kundërshtim të plotë me LPP.”

“[...] Së treti, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3. kapacitet teknike, të shtojcës 7 kriteret e vecanta të kualifikimit, të dokumentave standarte të tenderit, me anë të së cilës kërkohet që OE pjesëmarrës të kenë në dispozicion punonjës: i) minimalisht 1 (një) punonjës printues të cilët duhet të figurojnë në lispagesat e OE (i regjistruar detyrimisht me këtë kod): është gjithashtu tërësisht diskriminues, jo i lidhur drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës, jo proporcional; dhe mbi të gjitha në kundërshtim të plotë me LPP. Përpos faktit të sipërcituar, që një punonjës i tillë i specializuar nuk nevojitet aspak për realizimin e kësaj kontrate prokuruese, gjithashtu, fare mirë një OE pjesëmarrës mund të disponojë punonjës që mund të jenë të regjistruar në listëpagesa me një titullim profesional tjetër si për shembull i) ofsetist; ii) dizajner, iii. faqosës, etj.) dhe në të njëjtën kohë të kryejë edhe funksionet dhe detyrat e i) teknikut të printimit. pra nuk ka / ekziston asnjë arsye logjike, teknike, profesionale dhe funksionale përse një OE pjesëmarrës do të duhet të ketë një punonjës - i cili të figurojë detyrimisht i regjistruar në listëpagesa si i) punonjës printues ku fare mirë detyrat dhe

funkcionet e tij mund ti mbulojë një punonjës tjetër i cili është i regjistruar me një titullim + kod tjetër në listëpagesat e shtypshkronjës. Gjithashtu, ky kriter i vecantë bie në kundërshtim me vetë objektin e këtij prokurimi publik “shtypshkrime”. Vetë AK përcakton që objekti është “Shtypshkrime”, ndërsa nga ana tjetër kërkon që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë një staf të specializuar i) punonjës printues, dhe për më shumë, i cili do të duhet të figurojë paraprakisht (në të shkuarën) në listëpagesat e operatorit ekonomik pjesëmarrës (i regjistruar detyrimisht me këtë kod). Nëse AK mendon dhe beson që operatorët ekonomikë pjesëmarrës do të duhet të kenë patjetër në dispozicion një punonjës i cili të kryejë detyrat dhe funksionet e i) i) punonjës printues- kërkesë kjo aspak proporcionale dhe tërësisht jo e lidhur drejtëpërdrejtë me realizimin e kontratës prokuruese, për të cilën patëm mundësi të shprehim kundërshtimet tona në gjurmën a) të kësaj pike - përsëri, kërkesa që ky punonjës të jetë i regjistruar detyrimisht në listëpagesa me këtë titullim + kod, është një kërkesë jo proporcionale, e panevojshme dhe e ekzagjeruar, dhe për këtë arsye do të duhet të ndryshohet. Për sa më sipër, kriteri kualifikues që OE pjesëmarrës do të duhet të kenë në dispozicion punonjës të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat i) punonjës printues; do të duhet të hiqet / ndryshohet, pasi bie në kundërshtim të plotë me LPP.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, të modifikuara “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.3 është parashikuar kriteri si më poshtë:

ISHTE

Në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Marketing dhe Artet e aplikuara, Dega Grafike, si dhe minimalisht një teknik printimi të certifikuar të paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

- 1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)
- 2- 2- Për teknikun e printimit të paraqitet certifikata dhe CV.

BEHET

Në pikën 2.3.3. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të jenë me arsim të lartë në profilin Grafikë/ Design ose degë ekuivalente me to, si dhe minimalisht të ketë në staf punonjës printues. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë/deklaratë të firmosur nga Administratori i shoqërisë.

Lista e personelit kryesor duhet të shoqërohet me:

1- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025)

2- Për teknikun e printimit të paraqitet CV.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 i LPP-së parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga

regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.5. Ndërsa në nenin 39 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim,

të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Parë në këtë këndvështrim KKP gjykon ,se vendosja e e kriteri që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të profilit punonjës printues është në kërkesë e drejtë por autoriteti kontraktor me qëllim rritjen e konkurrencës dhe sigurimin e pjesëmarrjes së një numri sa më të gjërë pjesëmarrësish në procedurën e prokurimit duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri duke parashikuar edhe profesione të tjera alternative me punonjës in printues të cilët referuar objektit të kontratës mund të kryejnë të njëjtën natyrë pune me atë të punonjësit printues në funksion të realizimit në kohë dhe cilësi të kontratës. Ndërsa referuar kërkesës së autoritetit kontraktor që punonjësit e një profilli të tillë të figurojnë në listpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët e-Sig 025) Komisioni gjykon se për të njëjtin arsyetim si ai i përdorur më sipër për profilin grafik/design, kjo është një kërkesë e ekzagjeruar, pasi e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të specializuar për realizimin e kontratës objekt-prokurimi në kohë dhe me cilësi të cilët të jenë punonjës efektivë për sa kohë do të zgjasë realizimi i kontratës dhe duke e parë në këtë aspekt nuk është e domosdoshme që punonjësit printues apo profesione te ngjashem me to që mund të kryejnë të njëjtën natyrë pune të jenë të punësuar me kohë të plotë që të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, pasi operatori ekonomik mund të lidhë edhe kontrata të përkohshme me këto profile për kohën e vlefshmërisë së kontratës me qëllim që profilet e kërkuara t'i ketë në dispozicion gjatë kësaj kohe për realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të rishikuar kriterin duke parashikuar edhe alternativa të tjera të profileve të punonjësve por që mund të kryejnë të njëjtën natyrë pune me punonjës in printues si dhe të rishikojë kriterin që *lista e personelit për profilet më sipër "të shoqërohet me listpagesat e sigurimeve e shoqërore"*, pasi operatorët ekonomikë mund të disponojnë punonjësit më sipër

edhe përmes kontaktave të përkoheshme të cilat janë të vlefshme gjatë kohës së realizimit të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-66518-04-19-2023, me objekt “Shtypshkrime”, me fond limit 1,433,300 (një milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.03.2023, nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

